



## REGULLIMI I 'BLATËS SË HYJËSHME

Kur ka Prifti për të bërë Meshën e Perëndishme, duhet më parë të jetë i pajtuar me të gjithë e të mos ketë gjë kundër nonjëj, dhe, sa të mundë, t' a ruaj zëmëren prej mejtimesh të liga ; dhe të mbahet që mbrëmane, dhe të yigjëllojë gjer më kohën e Shërbesës së Shëntë. Dhe kur të vijë koha, pasi t' i bëjë faljet e zakonëshme të Parit, hyn në kishë ; dhe, si bashkohet me Diakun, bëjnë bashkë tri falje nga an' e Lindjes përpara Dyerve të Shënta, duke thënë :

O Perëndi, fal-më mua mëkatarin.

PASTAJ thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Lavdi ty, ô Perëndia jonë, lavdi më ty.

DIAKU :

Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar' i të mirave, dhe falësi i jetës ; eja dhe tendësô nër ne, dhe spastrô-na prej ç' do pikle, dhe shpëtô, ô i Mirë, shpirtet tona.

Shënt Perëndi, Shënt i Fuqishmë...

Trinî e Tërëshëntë...

Ati ynë që je ndë qiell...

PRIFTI :

Se jotja është Mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia,  
e Atit....

PASTAJ thotë :

Mëshirô-na, ô Zot, mëshirô-na, se duke mos  
patur tiatër mprojtje, ne mëkatarët të siellim ty, si  
Zoti, këtë lutje : mëshirô-na.

DIAKU :

Lavdî Atit....

Mëshirô-na, ô Zot, se te ty kemi shpresuar ; mos  
u-zëmërô tepër me ne, as mos kujtô paudhësitë  
tona ; po hith synë dhe tanî si zëmër-dhëmpshur,  
dhe shpëtô-na prej armiqve tanë ; se ti je Perëndia  
jonë, dhe neve populli yt ; të gjithë jemi vepra të  
duarve tënde dhe emërin tënt kemi thirrur.

PRIFTI :

Tanî e përherë...

Hap-na derën e zëmër-dhëmpshërisë, ô Hyjlin-  
dëse e bekuar ; duke patur shpresë te ty, le të mos  
humbasim, le të shpëtojmë me anën tënde prej  
rasjesh të liga ; se ti je shpëtimi i gjindjes së kri-  
shterëve.

DIAKU :

Mëshirô, ô Zot. (12 herë.)

Bëjnë kryq që te dy. Pastaj shkojnë karozë, Prifti përpara, dhe përshëndoshin korat e shënta.

Te Kor' e Jesu Krishtit thonë :

Korës s' ate së pacinuar i falemi, ô i Mirë, duke lypur ndiesë të fajeve tona, ô Krisht Perëndi ; se, duke dashur, dignove të ngjitesh trupërisht më kryqin, që të shpëtosh prej robërisë s' armikut atâ që gatove ; përandaj me mirënjohje po të thërresim : Me gas i mbushe të gjitha, ô Shpëtimtari ynë, kur erdhe për të shpëtuar botën.

Te e Hyjlindëses, thonë :

Duke qënë burim zëmër-dhëmpshërie, vlerësô-na me sympathî, ô Hyjlindëse ; hith synë mi popullin që mëkatoj, rrëfê si përherë fuqinë tënde ; se, duke shpresuar më ty « Gëzoh-u », te thërresim, si një herë Gabrieli, kryegeneral' i Engjëjve.

Pastaj përshëndoshin korët e tiera, duke thënë tropar' e Shëntit, e të tsilit është kora. Pasandaj kthehen te vëndi i tyre i parë ; DIAKU rri më te diathë të Priftit e i thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Dhe si unjim krerët, PRIFTI thotë këtë urim :

O Zot, ndeh doren tënde prej lartësirës së ndënjësore s' ate, dhe forcô-më te shërbimi yt i përparavënë, që të qëndroj pa dënim përpara Tribunës s' ate së trëmpshime e të mbaroj shërbesën e shëntë të pagjakëshme. Se jotja është fuqia, edhe lavdia, më jetët të jetëve. Amen.

## DIAKU :

Lavdî. Tanî. Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.) Bekô.

PRIFTI bën një Përlëshim të vogël kështu, në qoftë e Dielë :

Krishti Perëndia jonë e vërtetë, që u-ngjall së vdekurësh.....

Në mos :

Krishti Perëndia jonë e vërtetë....

Në qoftë Mesh' e Shën Vasilit, thotë më në funt :

T' Atit tonë nërmiet shëntorët Vasilit Kryepeshkopit të Kaisarisë së Kappadoqisë, Qiell-folësit të Math.

Në qoftë e Shën Gojartit :

T' Atit tonë nërmiet shëntorët Joan Kryepeshkopit të Konstantinopojës Gojartit.

Dhe, pasi falen tri herë dhe përshëndoshin popullin, hyjnë në Shëntërore, PRIFTI nga der' e veriut, dhe DIAKU nga der' e jugës, duke thënë që të dy dhe duke u-falur karoze :

Do të hyj te shtëpia Jote e shëntë, do t' i falem një Hynie që adhurohet më tri substanca, më Atin, e më Birin, e më Shpirtin Shënt, më jetët. Amen.

Dhë kështu përshëndoshin Ungjillin e Shëntë dhe Alltar' e shëntë. DIAKU i afërohet Priftit duke mbajtur të veshurat e shënta e thotë :

Bekô ô Zot, Stiharë bashkë me Orarë.

Dhe puth dorën e diathtë të PRIFTIT, i cili thotë :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Diaku shkon e vishet. PRIFTI merr dhe ay Stiharë dhe thotë :

O Perëndi fal- më mua mëkatarin.

Dhe falet tri herë. Pastaj e bekon, e puth dhe thotë :

E bekuar është Perëndia.....

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Dhe duke u-veshur thotë :

Do t' ngazëllohet shpirti im te Zoti ; se më veshi me robë shpëtimi dhe me këmishë gëzimi më pësh-tolli ; më vuri kurorë si një dhëndëri, dhe si nuse më stolisi me stolî. Për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Gjith' ashtû dhe DIAKU vishet dhe uron pa bekuar. Merr Orarë dhe, si e puth, e vë mi supin e mëngjër. Merr Mimëngët dhe më të diathtën, si e puth, thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Dora jote e diathtë, ô Zot, u-lavdërua me fuqî ; dora jote, ô Zot, theu armiqtë, dhe më shumicën e lavdisë s' ate dërmovë kundrështarët.

Më të mëngjërën, duke bërë gjith' ashtû, thotë :

Duart' e tua më bëne e më gatuan, bëj-më të mënçim dhe do t' mësoj urdhërimet e tua.

Pastaj shkon në Lanjëtove e thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Do të lanj duart' e mia nër të pafajshmit, dhe do të qerthulloj Alltarin tënt, ô Zot, që të dëgjoj zën' e lavdërimit tënt, e të pralloj tërë çudirat e tua. O Zot, dashurova mirhiesin' e shtëpisë s' ate, dhe vëndin e tendësimit tënt ; mos e hump shpirtin t' im bashkë me të pabesët, dhe rrojtjen t' ime bashkë me burra gjakatarë, nër duart' e të cilëve ka paudhësira ; e diathta e tyre u-mbush me dhurata ; po unë kam baritur në innokencën t' ime ; çprëblë-më, ô Zot, dhe mëshirô-më ; këmba ime qëndroj më drejtësi ; më kishërat do t' të bekoj, ô Zot.

Pastaj hyn në 'Blatën e shëntë dhe falet tri herë duke thënë :

O Perëndi, fal-më mua mëkatarë.

Dhe çpështjell Qelqin e shëntë duke thënë këtë Tropar :

Pregatit-u Bethlehem, u-hap për të gjithë Ede-mi ; stolis-u Eufatha, se druri i jetës lulëzoj në Shpellë prej Virgjëreshës ; se barku i saj u- rrëfye Parrajsë mëndore, ku ndodhet bima e hyjëshme, nga e cila do të hamë e do të rrojmë ; dhe do të mos vdesim si Adami. Krishti lindet, që do të ngrerë Korën që ra qëmoti.

Pastaj shtron mbulesën më të diathte, vë Diskun e shëntë prësipër, gjith' ashtu dhe Shtijëzën e shëntë, nxier Sfyngjer' e shëntë me vërejtje nga Qelq' i shëntë, e vë kundrejt Diskut me

Lugën e shëntë; shëkon Qelqin e shëntë mos ka brënda gjë. pastaj e vë më të diathtë të Diskut. Mbulesat me Erën dhe Yllthin i vë më të mëngjër, dhe kështu pret priftin. PRIFTI, si vesh Stiharë, merr Petrahilë, e shënon, e puth dhe thotë :

E bekuar është Perëndia, që derth hirin e tij mi priftërit e tij, si myrrë mi krye, që zbret mi miekrën, miekrën e Aaronit, që zbret mi anën e robës së tij

Pastaj merr Brezin dhe thotë :

E bekuar është Perëndia....

Dhe si e shënon thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

E bekuar është Perëndia që më ngjesh me fuqî, dhe m' a bëri udhën faqebardhë ; që i trajtoj këmbët e mia si prej kaprolli, dhe më qëndroj më të lartat. Për gjithmonë; tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj merr Mimëngët dhe bën siç thamë më sipër. Në qoftë Arqimandrit vesh Epigonatin dhe thotë :

Ngjesh shpatën tënde më mezë tënt, ô i fortë, me bukurinë tënde, dhe me hien tënde ; dhe çap-u përpara, më udhën e mbarë dhe mbretërô me të vërtetën, butësinë, dhe drejtësinë ; dhe dora jote e diathtë do të heqë udhën çuditërisht. Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj merr Felonë, dhe si e bekon, e puth, duke thënë :

Priftërit e tû, ô Zot, do të vishen me drejtësi

dhe oshënarët tënt do t' ngazëllohen me ngazëllim.  
Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.  
Amen.

Vete në Lanjëtooren dhe bën atô që u-thanë për Diakun  
Pastaj vien në Blatë, falet tri herë dhe thotë :

O Perëndî, fal-më mua mëkatarin, dhe mëshirô-  
më.

Merr meshën dhe Shtijëzën e shëntë, me të dyja duartë, e  
ngre gjer në ballë të tij dhe thotë :

Na çpërbleve prej mallkimit të ligjes, me gjakun  
tënt të çëmuar; duke u-mbërthyer më kryq, e duke  
u-çpuar me shtijëzë, u-burove njerëzive pavde-  
kurinë : Shpëtimtari ynë, lavdî më ty.

Pastaj thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI bekon dhe duke mbajtur meshën dhe Shtijëzën bën  
shënjën e kryqit mi Diskun, duke thënë :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî  
e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj PRIFTI, duke mbajtur meshën me dorën e mëngjër  
dhe Shtijëzën me dorën e diathtë, dhe si thotë DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Bën kryq me Shtijëzën përmi meshën, duke thënë :

Për kujtim të Zotit, dhe Perëndisë, dhe Shpëtim-  
tarit tonë Jesu Krisht.



DIAKU thotë :

Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.  
Amen.

Këtë e bën për-së-treti Prifti. Pastaj thotë DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

Dhe PRIFTI e kall Shtijëzën më anën e diathtë të meshës dhe, duke prerë, thotë :

Si dele u-hoq më therrje.

Më të mëngjërën thotë :

Dhe si qenq i pafajshim nukë nxier zë përpara atij që e qeth, ashtu nuk e hap gojën e tij.

Më anën e sipërme të shilës thotë :

Më perunjësimin e tij gjykim' i tij humbi.

Më anën e poshtme thotë :

Po brezin e tij kush do t' a rrëfejë ?

DIAKU, duke vësthruar me reverim këtë çerimonje, thotë më ç' do prerje :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot. — Duke mbajtur

Orarë më dorën e diathtë. Pastaj thotë :

Ngrej-e, ô Zot.

PRIFTI atëhere, duke futur Shtijëzën e shëntë brinjthi nga an' e mëngjër e meshës, ngre bukën e shëntë dhe e vë te Disku i shëntë, duke thënë :

Se ngrihet prej dheut jet' e tij.

Dhe si e vë më-krahëza (do-me-thënë për-së-prapi) te disku i shëntë, si thotë DIAKU :

Sakrifkô, ô Zot.

E sakrifikon me Shtijëzën kryqthi, dyke thënë :

Sakrifkohet qengj' i Perëndisë që ngre mëkatën e botës, për jetën dhe shpëtimin e botës.

Prapë thotë DIAKU :

Kryqësô, ô Zot.

PRIFTI prapë me Shtijëzën, duke sakrifkuar, thotë :

Kur u-kryqësove ti, ô Krisht, u-vra shtyrania, u-shkel fuqi' e armikut ; se as Engjëll, as njeri, po vetë Zoti na shpëtoj ; lavdâ më ty.

Dhe me një herë e kthen Qengjin nga faqeja (do me thënë nga shila), duke thënë DIAKU :

Çpô, ô Zot.

PRIFTI, duke çpuar me Shtijëzën nga an' e diatht' qengjit permi N- ne, thotë :

Një prej ushtarët e çpoj brinjën e tij me shtijëzë, dhe me-një-herrë rrodhi prej brinjës së tij së shëntë gjak dhe ujë, dhe ay që e ka parë ka dëshmuar, dhe i vërtetë është dëshmim' i tij.

DIAKU merr të dyja enët, të verës e të ujit, dhe, duke mbajtur më dorën e diathtë verën, dhe më të mëngjërën ujën, shtie më Qelqin e shëntë sa duhet, duke i thënë PRIFTI m' atë kohë :

Bekô, ô Zot, bashkimin e shëntë.

Dhe PRIFTI, duke bekuar permi Qelqin e shëntë, thotë :

I bekuar është bashkim' i Shëntorëve tënt.

DLAKU :

Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.  
Amen.

Pastaj vë PRIFTI përmi Qelqin e shëntë dy mbulesat dhe Yllthin. DLAKU shkon e ujdís Alltar' e shëntë dhe rishvështron Ungjillin që do t' këndojë. PRIFTI, duke marrë meshën e dytë dhe si e shënon me Shtijëzën, nxier piesën e Hyjlindëses kështu duke tëhnë :

Për nder dhe kujtim të Zonjës s' onë së përmibe-  
kuar, të lavdëruar, Hyjlindëses, dhe gjithmon-  
virgjërës Marî, me nërmjetimet e së cilës, akseptô,  
ô Zot, këtë therore në Alltarë tënt të përmiqiell-  
shim.

Dhe, duke ngritur piesën e Hyjlindëses me Shtijëzën, e vë më anën e diathtë të Bukës së shentë, anës mezit të tij, duke thënë :

Qëndroj Mbretëresha më të diathtë tënt, me të veshura të punuara me ar e pështjellë, dhe e stolisur me ngjyra të ndryshme.

Pastaj gjithë prej asaj meshe nis të nxierë nëndë urdhëret më piesa më tri radhë kështu. Duke ngritur piesën e parë thotë :

Për nder dhe kujtim të kryeurdhërve të fortmë-  
dhej Mihael dhe Gabriel, dhe të gjithë Fuqive Qie-  
llore.

Dhe e vë më anën e mëngjër të Bukës së shëntë, anës mezit. Pastaj ngre pjesën e dytë, duke thënë :

Të ndershmit dhe të lavdëruarit Profet, Parë-rendës dhe Pagëzor Joan ; të shëntëve dhe të lavdëruarve Profetër, Moisi dhe Aaron, Elia, Elis, David dhe Jesse ; të tre Diemve të shëntë, dhe Profetit Daniel, dhe të gjithë Profetërve të shëntë.

Dhe e vë nënë pjesën e parë me regull. Duke ngritur pjesën e tretë, thotë :

T' Apostujve të shëntë, të lavdëruar, dhe emërshkëlqyer Pietër dhe Paul, të Dymbëdhjetëve, dhe të Shtatëdhjetëve, dhe të gjithë Apostujve të shëntë.

Dhe e vë pjesën e tretë nënë të dytën dhe mbaron radhën e parë. Pastaj ngre pjesën e katërt, duke thënë :

T' Atërve tanë nërmiet shëntorët dhe Mësonjësve të Mëdhej Ekumenikë dhe kryepriftërve, Basilit të Math, Gregorit Theolog, dhe Joan Gojartit, Athanasit dhe Kyrillit, Nikollit të Myrave dhe tërë kryepriftërve të shëntë.

Dhe e vë pranë pjesës së parë, duke bërë nisje të radhës së dytë. Pastaj ngre pjesën e pestë, duke thënë :

Shën-Stefanit, dëshmorit të parë dhe kryediakut, Dëshmorëve të shëntë, të lavdëruar dhe të mëdhej, Gjergj Tropeprurësit, Demetrit Myrobletit, Theodorëve te Tyronit dhe krye-ushtarit, dhe të gjithë Dëshmorëve e Dëshmorkave të shënta.

Dhe e vë nënë piesën e parë të radhës së dytë. Pastaj ngre piesën e gjashtë, dhe thotë :

T' Atërve tanë oshënarë dhe Hyjprurës Andonit të Math, Efthimit, Paisit, Sabbës, Onufrit, Pietrit dhe Athanasit të Athonit, Dionisit te Olympit dhe tërë atyre që shkëlqyen që prej jete n' ashkëtismë.

Dhe e vë nënë piesën e dytë, dhe mbarohet radh' e dytë. Pastaj, duke ngritur piesën e shtattë, thotë :

T' Anargjëndëve të shëntë, të lavdëruar dhe çudî-bërës, Kosma dhe Damian, Kyro dhe Joan, Pantelimon dhe Hërmola, Thalale, Tryfon dhe Kristofor, dhe të gjithave e të ghithëve Shën-Anargjëndër.

Dhe e vë sipër anës së dytës piesë, duke nisur radhën e tretë. Pastaj, duke ngritur piesën e tettë, thotë :

Të Hyjprindërve të shëntë e të drejtë Joakim dhe Annes, Josef Vlesorit, dhe Simeon Hyjpritësit ; dhe të shëntit të ditës (*aksh*), te cilin po lusim sot, dhe të gjithë Shëntorëve tënt.

Dhe e vë nënë të shtattën piesë të radhës së dytë. Pastaj ngre piesën e nënttë.

T' Atit tonë nërmiet shëntorët Joan Kyrepshkopit të Konstantinopojës Gojartit (*ose të Basilit të Math, në qoftë se bëhet Meshë e tij*), Meshën e të cilit të perëndishme po bëjmë ; ô i shënt' i Perëndisë, nërmjetô për ne.

Dhe e vë nënë piesën e tettë dhe kështu mbarohen tri radhat e nëndë Urdhërve. Pastaj merr thikën, pret dy copëra nga ajô

meshë, dhe merr nga njëra copë pjesa për të gjallët dhe nga tija-  
tëra për të ndyerit. Dhe duke mbajtur njëren copë me dorën e  
mëngjër me tre gjishtër, dhe me dorën e diathtë Shtijëzën e  
shëntë, thotë :

Kujtô, ô Zot, ç' do peshkopî Orthodoxësh dhe  
kryepeshkopin (*a peshkopin*) tonë (*aksh*), të nder-  
shmen Presbytëri, Diakonatën më Krisht dhe ç' do  
urdhër Priftëror.

Kujtô, ô Zot, Atin tonë Kathegumen (*aksh*) dhe  
tërë vëllezërit tanë të këtij Monasteri të shëntë dhe  
bashkë - meshëtarët tonë priftër, hierokllogjër,  
hierodiakër, kllogjër, e kllogjëresha, që i ftove më  
shokërine tënde, nga zëmër-bardhësia jote, ô Zot i  
Fortmirë.

Pastaj kujton emërin e atî për të cilin bëhet Mesha e Hyjë-  
shme dhe ngre pjesa të veçanta ; pastaj kujton atâ që dô dhe e  
lë këtë copë. Pastaj merr copën tiatër dhe thotë :

Lutemi edhe për kujtimin e lumur dhe ndiesën e  
mëkateve të Ndertonjësve të lumur të këtij Monas-  
teri të shëntë (ose të Kishës).

Pastaj kujton kryepriftin që e urdëhroj dhe atâ që dô ; më në  
funt, duke zbritur pjesa, kujton kështû :

Kujtô, ô Zot, Mbretër, Patrikër, Kryepriftër,  
Priftër, Hierokllogjër, Hierodiakër, Kllogjër, e Kllö-  
gjëresha; dhe gjithë Atërit dhe vëllezërit tanë Ortho-  
doxë të ndyer në shokerinë Tënde me shpresë jete  
t' ameshuar, ô Zot njerzidashës

Dhe më-s-ëfundi thotë kështu :

Kujtô, ô Zot, dhe pavlerësinë t' ime, dhe ndje më ç' do faj të dashur dhe të padashur.

Pastaj e lë dhe atë copë. Mbleth mirë presat e shpirtëve me Shtijëzën nënë Bukën e shëntë ; lë Shtijëzën më vëndin e saj ; fshin buzët e Diskut të shëntë me mbulesën e shtruar mirë. Diskun e lë më vëntt të tij, dhe mbulesën e palos dhe e shpie në Alltar të shëntë. Pastaj DIAKU përgatit temianicën dhe i a ep Priftit, duke thënë :

Bekô, ô Zot, temianë. Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Duke bekuar PRIFTI thotë Urimin e temianit.

Temian po të 'blatojmë, ô Krisht Perëndia jonë, si erë fragrance shpirtore ; prit-e te Alltari yt i përmiqellshim, dhe na dërgô si çpërblim hirin e Shpirtit tënt të Tërëshëntë.

Pastaj PRIFTI merr Yllthin dhe i afërohet temianicës. DIAKU duke mbajtur temianiëcn e temianis duke thënë :

Le t' i lutemi Zotit.

Gjith' ashtu bën dhe për Mbulesat dhe për Erën. PRIFTI e vë Yllthin mi Bukën e shëntë dhe, si e puth, thotë :

Dhe erdhi Ylli dhe qëndroj përsipër, atie ku ish Dialthi.

Pastaj PRIFTI, duke marrë Mbulesën e parë, dhe si e temianis DIAKU duke thënë :

Le t' i lutemi Zotit.

Mbulon Diskun e shëntë, duke thënë :

Zoti mbretëroj, u-vesh me mirhiesâ; Zoti u-vesh dhe u-ngjesh me fuqî; se shiguroj gjithësinë, e cila do të mos tundet.

Dhe, si e puth, e vë me reverim. Pastaj PRIFTI merr Mbulësën e dytë, dhe DIAKU bën siç u-tha sipër dhe i thotë Priftit :

Le t' i lutemi Zotit. Mbulô, ô Zot.

Dhe PRIFTI mbulon Qelqin e shentë, duke thënë :

Mbuloj qiejtë virtyti yt, ô Krisht, e dheu është plot prej lavdërimit tënt.

Pastaj, siç merr PRIETI Erën, DIAKU e temianis duke thënë :

Le t' i lutemi Zotit. Mbulô, ô Zot.

PRIFTI i mbulon që të dyja, Diskun dhe Qelqin, duke thënë :

Mbulô-na me hien e krahëve tënt; dbô prej nesh ç' do armik dhe kundrështar; paqësona-e jetën; ô Zot, mëshirô-na ne dhe botën tënde, dhe shpëtô-i shpirtet tona, si i mirë dhe njerzidashës.

Pastaj merr PRIFTI Temianicën dhe temianis tri herë Parëvënjen, duke thënë :

E bekuar je, ô Perëndia jonë, që të pelqeu kësh-tû; lavdî më ty.

DIAKU ç' do herë thotë :

Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.  
Amen.



Pastaj merr DIAKU Temianicën prej dorës së Priftit, passi e puth, i ep Librin dhe i thotë :

Për Parëvënjen e shëntë dhe hierore të Dhuratave të çëmuara, le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

PRIFTI këndon Urimin e Parëvënjes :

O Perëndî, Perëndia jonë, që dërgove Bukën qiellore, ushqimin e tërë botës, Zotin tonë, dhe Perëndinë Jesu Krisht, si Shpëtimtar, dhe Çpërblenjës, dhe Mirëbërës që na bekon e na shëntëron; ti bekô dhe këtë Parëvënje dhe prit-e te Alltari yt i përmiqiellshim Kujtô, si i mirë dhe njerzidashës, atâ që 'blatuan, dhe atâ për të cilët 'blatuan; dhe neve ruaj-na faqe-bardhë më shërbesën e shëntë të Mysterëve tënt të hyjëshme. Se është i shëntëruar dhe i lavdëruar emëriyt i gjith-ndershim dhe madhështor, i Atit, e i Birit, dhe i Shpirtit Shënt, taní e përherë; e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj pas Urimit bën një Përlëshim të vogël, duke thënë :

Lavdî ty, ô Krisht Perëndî, shpresa jonë, lavdî më ty.

DIAKU :

Lavdî. Taní. Mëshirô, ô Zot. O Zot i shëntë, bekô.

PRIFTI bën Përlëshimin e 'Blatës kështú :

Ay që lindi në Shpellë dhe fieti në grazhde për shpëtimin tonë (në qoftë e Dielë, thua j dhe : *dhe u-nyjall së*

*vdekurësh*), Krishti Perëndia jonë e vërtetë, me nërmjetimet e Emës së tij së Pacinuar dhe të Shëntë ; të Profetit Parërendës dhe Pagëzor Joan ; te shëntit të ditës (*aksh*) ; t' Atit tonë nërmiet shëntorët Joan Kryepeshkopit të Konstantinopojës Gojartit (ose : të *Shën Basilit të Math* në qoftë se bëhet Mesh' e tij); dhe të gjithë Shëntorëve na mëshiroftë e na shpëtoftë, si i mirë dhe njerzidashës.

Si mbarohet Përlesëhimi, falen që të dy, dhe PRIFTI puth kryqthi të shëntat, duke thënë :

Shënt Perëndî, Ati i Panisjeshim ; Shënt i Fuqishmë, Bir' i Bashkëpanisjeshim ; Shënt i Pavdekur, Shpirt' i Tërëshëntë ; Trinî e shëntë, lavdî më ty.

DIAKU, si thotë *Amen* puth dhe ay anën e poshtme të Erës; temianis Parëvënjen e shëntë tri herë; gjith' ashtu dhe Alltar' e shëntë rreth-përçark kryqthi, duke thënë më vete këtë Tropare :

Në varrt trupërisht, në Ferr me shpirtin tënt si Perëndî, në Parrajsë me Kusarë, dhe në Fron bashkë me Atin e me Shpirtin, ishe, ô Krisht, ti i papërshkruari që mbush të gjitha.

Lavdî Atit....

Varri yt, ô Krisht, burim' i ngjalljes s' onë, urrëfye, si jetëprurës, më i bukur se Parrajsa, dhe me të vërtetë, më i ndritshim se dhomë Mbretërore.

Tanî.... Hyjlindësore.

Gëzoh-u, ô tendësim i shëntëruar i Perëndisë së Lartë, se me anën tënde është dhënë gazi, ô Hyjlin-

dëse, nër atâ që thërresin : E bekuar je ti në mest të grave, ô Zonjë e Bardhë.

Pastaj del nga Dyert' e Tribunës dhe qëndron përpara Derës së Bukur; temianis Korët Zotërore, Fronin e Peshkopit, Vallet më të diatht' e më të mëngjër, duke thënë fshehtazi Psalmin 51. Pastaj hyn brënda andej ngaha dolli. Temianis përsëri Alltarë, Parëvënjen, dhe priftërinë ; e vë Temianicën më vëntt, dhe duke i u-afrëuar Priftit më të diathtë të Alltarit, karos, dhe me kokë unjur i thotë :

Eshtë kohë t' i shërbejmë Zotit. Bekô, ô Zot.

PRIFTI, duke shënuar kryet e Diakut, thotë :

E bekuar është Perëndia jonë, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Lut-u për mua, ô Zot i shëntë.

PRIFTI :

Zoti i drejtësoftë përçapet e tua më ç' do punë të mirë.

DIAKU :

Kujtô-më, ô Zot i shëntë.

PRIFTI :

Zoti Perëndî e kujtoftë hierodiakërinë tënde, në Mbretëri të tij, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU, pasi thotë *Amen*, falet, puth Ungjillin, Alltarë të diathtën e Priftit dhe del nga Dyert' e shënta. Dhe, si unj kryet, falet fshehtazi këtô :

Mbret qiellor, Ngushëllimtar.....

Lavdî Perëndisë më të lartat, dhe mi dhenë paqja, dhe mi njerëzit mirëdashja. (Tri herë.)

O Zot, çel-m' i buzët dhe goja ime do t' a lajmërojë lavdimin tënt. (Dy herë.)

Pastaj DIAKU : " Bekô, ô Zot ,,

PRIFTI : " E bekuar është Mbreteria e Atit, .... ,,

(Shëkô në Meshë të Gojartit.)

S. P. Këtô të 'Blatës thohen të gjitha fshehtazi.